


REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E QEVERISJES ELEKTRONIKE DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT
SEKTORI I KONSULTIMIT PUBLIK DHE OPINIONEVE QYTETARE

Raport sondazhi

Mbi cilësinë e shërbimit në kopshtet dhe çerdhet publike



Dhjetor 2024

Përmbajtja

Rreth sondazhit	3
Koha që u kushtohet fëmijëve nga stafi edukator	4
Marrëdhënia prind-staf edukator	5
Shërbimi psiko-social	6
Programi i edukimit në çerdhe dhe aktivitetet në kopshte	7
Numri i fëmijëve në grup	8
Vlerësimi për ushqimin	9
Vlerësimi për gjëndjen e ndërtesave dhe pajisjeve	10
Cilësia dhe siguria e hapësirave të dedikuara për aktivitete dhe argëtim	11
Lehtësia për të gjetur kopësht/çerdhe pranë vendbanimit	12
Regjistrimi i fëmijëve	13
Oraret e pritje-përcjelljes	14
Vlerësimi i përgjithshëm për shërbimin	15
Rekomandimi i kopshteve/çerdheve publike tek prindër të tjerë	16
Sugjerime	17
Aneks I - Demografia	18
Aneks II - Kampionimi	19
Aneks III - Pyetësi i sondazhit	20

Rreth sondazhit

Bashkia e Tiranës ka për mision sigurimin e të drejtave dhe mirëqenies së të gjithë fëmijëve, duke përmirësuar cilësinë e jetës së tyre, duke siguruar shëndetin fizik e mendor dhe edukimin e zhvillimin e gjithanshëm.

Për të përmirësuar shërbimin e kujdesit parashkollor Bashkia e Tiranës (BT) kryen investime që konsistojnë në ndërtimin e godinave të reja, rikonstruksione të plota dhe të pjesëshme, shtimin e mjediseve të reja aty ku ka vend, si edhe zgjerimin e hapësirave të akomodimit apo shtimin e grupeve.

Gjithashtu BT-ja zhvillon rregullisht trajnime me stafet edukatore nga psikologët dhe punonjësit social, me fokus përgatitjen për të pritur fëmijët e rinj, komunikimin me prindërit, zbatimin e protokollit për përshtatjen e fëmijëve, përmirësimin e aftësive mësimdhënëse etj.

Ky sondazh ka për **qëllim** të hulumtojë opinionet rreth këtij shërbimi kaq të rëndësishëm duke nxjerrë në pah:

- Vlerësimin për kohën që u kushtohet fëmijëve dhe marrëdhënien prind-staf edukator;
- Vlerësimin për infrastrukturën dhe ushqimin që ofrohet në kopshte dhe çerdhe;
- Nëse prindërit hasin vështirësi për të gjetur kopësht/çerdhe pranë vendbanimit dhe për të regjistruar fëmijët;
- Nëse oraret e pritje-përcjelles përshtaten me nevojat e familjes;
- Sugjerime nga të anketuarit për të përmirësuar shërbimin dhe kushtet etj.

Sondazhi u zhvillua në periudhën **tetor-dhjetor 2024** dhe u përfshinë **1135** prindër dhe persona kujdestarë rastësorë.¹ Anketimi² u krye nëpërmjet **intervistave ballë për ballë** në të gjitha kopshtet dhe çerdhet publike të njësisë administrative urbane të Bashkisë Tiranë si dhe **online** në faqen zyrtare të institucionit dhe rrjetet sociale Instagram dhe Facebook.³

Nga totali i të anketuarve 66% janë femra dhe 34% meshkuj, 73% janë prindër dhe 27% persona kujdestarë, 45% e të anketuarve të punësuar në sektorin privat, 22% të papunësuar, 21 të punësuar në sektorin publik etj. (*Demografia – Ankes I*).



¹ Ankes I - Demografia..

² Ankes II - Kampionimi..

³ Aneks III - Pyetësori i sondazhit.



Koha që u kushtohet fëmijëve nga stafi edukator

Për kohën që u kushtohet fëmijëve nga stafi edukator në çerdhe rezultojnë të kënaqur 66% e të anketuarve, ndërsa në kopshte 72% etj. (Grafikët 1 dhe 2).





Marrëdhënia prind-staf edukator

Marrëdhënia prind-staf edukator për çerdhet vlerësohet mesatarisht 3.7 pikë në një vlerësim nga 1 në 5, ku 1 tregon shumë të pakënaqur dhe 5 tregon shumë të kënaqur, ndërsa për kopshtet vlerësimi mesatar është 3.5 pikë etj. (Grafikët 3 dhe 4).



Shërbimi psiko-social



Për sa i përket shërbimit psiko-social që ofrohet në çerdhet dhe kopshtet publike vlerësimi i të anketuarve është pothuajse i barabartë në kopshte dhe çerdhe (rreth 80% mirë) etj. (Grafikët 5 dhe 6).



Programi i edukimit në çerdhe dhe aktivitetet në kopshte

59% e të anketuarve janë të kënaqur me programin e edukimit në çerdhe, 32% nuk kanë dhënë një përgjigje, ndërsa 9% janë të pakënaqur.



74% e të anketuarve janë të kënaqur me programin e aktiviteteve në kopshte, 22% nuk kanë dhënë një përgjigje, ndërsa 4% janë të pakënaqur (*Grafikët 7 dhe 8*).



Numri i fëmijëve në grup



Numri i fëmijëve në grup konsiderohet i lartë nga 48% e të anketuarve në çerdhet publike, 33% e konsiderojnë optimal, ndërsa 19% shumë të lartë.

Në kopshtet publike 49% e konsiderojnë të lartë numrin e fëmijëve në grup, 36% shumë të lartë, ndërsa 15% optimal (Grafikët 9 dhe 10).





Vlerësimi për ushqimin

Në çerdhet publike 47% e të anketuarve janë mesatarisht të kënaqur me sasinë dhe cilësinë e ushqimit dhe 43% janë mesatarisht të kënaqur me larminë e ushqimit, ndërsa në kopshtet publike 48% janë mesatarisht të kënaqur me larminë e ushqimit dhe 47% janë të kënaqur me sasinë e ushqimit (Grafikët 11 dhe 12).





Vlerësimi për gjëndjen e ndërtesave dhe pajisjeve

Gjëndja e ndërtesave dhe pajisjeve në çerdhet publike vlerësohet mirë nga 49% e të anketuarve dhe e pranueshme nga 30%, ndërsa në kopshtet publike 44% kanë vlerësuar mirë dhe 37% pranueshëm etj. (Grafikët 13 dhe 14).





Cilësia dhe siguria e hapësirave të dedikuara për aktivitete dhe argëtim

Për cilësinë dhe sigurinë e hapësirave të dedikuara për aktivitete dhe argëtim, të anketuarit kanë dhënë vlerësime afërsisht të barabarta, 67% të kënaqur për çerdhet dhe 65% të kënaqur për kopshtet etj. (Grafikët 15 dhe 16).



Lehtësia për të gjetur kopësht/çerdhe pranë vendbanimit



68% e të anketuarve janë përgjigjur se ka qenë e lehtë të gjejnë çerdhe publike pranë vendbanimit dhe 70% kanë pohuar të njëjtën gjë për kopshtet publike etj. (Grafikët 17 dhe 18).



Regjistrimi i fëmijëve



46% e të anketuarve pranë çerdheve janë përgjigjur se nuk kanë hasur aspak vështirësi në regjistrimin e fëmijëve, 42% kanë hasur pak vështirësi, ndërsa 12% shumë.

49% e të anketuarve pranë kopshteve janë përgjigjur se nuk kanë hasur aspak vështirësi në regjistrimin e fëmijëve, 38% kanë hasur pak vështirësi, ndërsa 13% shumë (*Grafikët 19 dhe 20*).





Oraret e pritje-përcjelljes

Oraret e pritje-përcjelljes konsiderohen të përshtatshme për 91% e të anketuarve në çerdhe dhe të papërshtatshme për 9%. Në kopshte 95% i konsiderojnë të përshtatshme oraret, ndërsa 5% të papërshtatshme (*Grafikët 21 dhe 22*).





Vlerësimi i përgjithshëm për shërbimin

Në një vlerësim të shkallëzuar nga 1 në 5, ku një tregon aspak të kënaqur dhe 5 tregon shumë të kënaqur, për çerdhet publike vlerësimi mesatar është 3.72 pikë, ndërsa për kopshtet publike 3.65 pikë etj. (Grafikët 23 dhe 24).



Rekomandimi i kopshteve/çerdheve publike tek prindër të tjerë

Për sa i përket rekomandimit të kopshteve dhe çerdheve publike tek prindër të tjerë, rezultatet janë afërsisht të barabarta, me 81% e të anketuarve që i rekomandojnë çerdhet dhe 83% që i rekomandojnë kopshtet etj. (Grafikët 25 dhe 26).





Sugjerime

Një pjesë e të anketuarve (151) kanë shprehur sugjerime lidhur me përmirësimin e shërbimit dhe kushteve në kopshtet dhe çerdhet publike:

- 60 sugjerime për ndërtimin e më shumë kopshteve dhe çerdheve
- 55 sugjerime për të ulur numrin e fëmijëve në grup
- 20 sugjerime për të përmirësuar furnizimin me materiale pastrimi dhe higjenizimi
- 16 sugjerime që kopshtet dhe çerdhet të jenë të hapura ditën e shtunë deri në orën 13:00

Aneks I - Demografia



Aneks II - Kampionimi

Nr.	Anketimi	Pyetësorë të plotësuar
1	Ballë për ballë, pranë çerdheve publike	430
2	Ballë për ballë, pranë kopshteve publike	520
3	Online, në faqen zyrtare të Bashkisë Tiranë dhe rrjete sociale	185
Total pyetësorë		1135

Aneks III - Pyetësi i sondazhit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E QEVERISJES ELEKTRONIKE DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT
SEKTORI I KONSULTIMIT PUBLIK DHE OPINIONEVE QYTETARE

Nr. i pyetësit _____

Data _____/_____/2024

PYETËSOR

MBI SHËRBIMIN DHE KUSHTET NË KOPSHTET DHE ÇERDHET PUBLIKE

Çerdhja/Kopshti Nr.	Nj.Administrative	Gjinia		Grupi	
		F	M	Prind	Person kujdestar

Prindi i punësuar në:

Sektorin publik Sektorin privat I/E papunësuar Preferoj të mos përgjigjem

1. Sa të kënaqur jeni me kohën që i kushtohet individualisht fëmijës tuaj nga edukatorët?

Shumë të kënaqur Të kënaqur Të pakënaqur Shumë të pakënaqur

2. Si e vlerësoni marrëdhënien tuaj me stafin e edukatoreve në aspektet e mëposhtme? (Vlerësoni nga 1 deri në 5, ku 1 është "Shumë i pakënaqur" dhe 5 është "Shumë i kënaqur")

- Informimi i rregullt mbi ecurinë dhe zhvillimin e fëmijës
- Përshtatja e edukatorit me nevojat specifike të fëmijës
- Disponueshmëria e edukatorit për të diskutuar çështje rreth mirëqenies së fëmijës
- Komunikimi dhe këshillimi për çështjet edukative dhe zhvillimore
- Trajtimi profesional dhe përkujdesja ndaj fëmijës

3. A jeni të kënaqur me programin edukativ – mësimor (kurrikulat pedagogjike)?

Po Jo Pa përgjigje

- Nëse Jo, specifiko arsyen.

4. A mendoni se numri i fëmijëve në grup është i përshtatshëm për një zhvillim të mirë?

Po Jo Nuk jam i/e sigurt

5. Sa të kënaqur jeni me ushqimin që fëmija juaj konsumon në çerdhe/kopsht:

Nr	Treguesi	Aspak të kënaqur	Pak të kënaqur	Mesatarisht të kënaqur	Të kënaqur	Shumë të kënaqur
1	Sasia & cilësia e ushqimit					
2	Larmia e ushqimit					
3	Uji i pijshëm					

6. Si e vlerësoni gjendjen e ndërtesës dhe pajisjeve në çerdhen/kopshtin që ndjek fëmija juaj?

Shumë e mirë E mirë E pranueshme E dobët

7. Si e vlerësoni cilësinë dhe sigurinë e hapësirave të dedikuara për aktivitete dhe argëtim në çerdhen/kopshtin që ndjek fëmija juaj?

Shumë të kënaqur Të kënaqur Të pakënaqur Shumë të pakënaqur

8. A ishte e lehtë për ju të gjeni një çerdhe/kopsht publik pranë vendbanimit tuaj?

Po Jo Pa përgjigje

9. A keni pasur vështirësi në regjistrimin e fëmijës tuaj në çerdhen/kopshtin pranë banesës suaj?

Po Jo

10. A janë oraret e pritjes-përcjelljes së fëmijëve të përshtatshme për ju dhe familjen tuaj?

Po Jo

11. Sa të kënaqur jeni në përgjithësi me shërbimin në kopshtet dhe çerdhet publike?

Aspak të kënaqur – 1 2 3 4 5 – Shumë të kënaqur

12. A do t'i rekomandonit kopshtet dhe çerdhet publike tek prindër të tjerë?

Po Jo Nuk e di

13. Sugjerime dhe komente:

Shënim: Ky pyetësor organizohet nga Bashkia e Tiranës dhe ka për qëllim vjeljen e opinionit të qytetarëve mbi shërbimin, kushtet dhe infrastrukturën në **çerdhet dhe kopshtet publike**.

Ju sigurojmë që të dhënat tuaja janë për qëllim studimi dhe në përputhje me Ligjin nr. 139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; Ligjin 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik"; Ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"; Ligjin nr. 120/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar".